



**Kompania e Ujësjesit Rajonal “Prishtina” SHA,**

**Pasqyrat Financiare dhe Raport i Auditorëve të pavarur  
31 Dhjetor 2011**



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Bilanci i Gjendjes.....	5
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-22



# Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Menaxhmentin dhe Aksionarët e Kompanisë së Ujësllësit Rajonal "Prishtina" sh.a

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Kompanisë së Ujësllësit Rajonal "Prishtina" sh.a (tutje referohet si "Kompania") që përbëhen nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2011, Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon, dhe përmbledhjen e politikave kryesore të kontabilitetit dhe shënimet tjera sqaruese, të përfshira në faqet 5 deri 22.

Pasqyrat Financiare të Kompanisë me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010 janë audituar nga një auditor tjetër opinioni i të cilit mbi keto pasqyra ka qenë i kualifikuar për kalkulimin e zhvleresimit të asetëve për qëllime të tatimit dhe salldon e llogarive të arkëtueshme duke përfshirë kalkulimin e provizioneve për borxhe të kqija.

## ***Përgjegjësit e menaxhmentit për pasqyrat financiare***

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të mbrendshëm që është i rëndësishëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të këtyre pasqyrave financiare që janë të liruara nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjes dhe aplikimit të politikave të duhura kontabël; dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

## ***Përgjegjësia e Auditorit***

Përgjegjësi e jona është të shprehim një mendim në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Përveç diskutimeve në paragrafët në vijim, ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe planifikojmë dhe zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë performimin e procedurave që të arrijmë evidencë audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga gabimi apo mashtrimi.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e mbrendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e duhur të politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmëria e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia audituese që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e duhur që të ofrojmë bazë për mendimin tonë.

***Bazat për mendimin e kualifikuar***

1. Siç është shpalosur në Shënimin 3 të pasqyrave financiare përcjellëse më 31 Dhjetor 2011, vlera bartëse neto e pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë është 54,545,625 Euro (2010; 57,393,895). Prona, impiantet dhe pajisjet e Kompanisë janë bartur në koston e tyre ose në rivlerësim minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmit. Megjithatë, politika e kontabilitetit në lidhje me matjet pasuese për provizionin e dëmit në asetet subjekte të zhvlerësimit siç është shpalosur në shënimin 2.3, kërkon nga manaxhmenti të kryejnë testimin e “dëmit” kurdo që ka indikacione të cilat mund të tregojnë që vlera bartëse e tyre nuk mund të rikuperohet. Ne nuk ishim në gjendje të kënaqim vetveten se ky testim është kryer mbi zërat e rëndësishëm të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes pasi që ka indikacione që tregojnë që vlera bartëse e tyre nuk mund të rikuperohet pasi që shkalla e inkasimit është e ulët dhe Kompania operon në humbje. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të kënaqim vetveten me vlerën bartëse neto të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë më 31 Dhjetor 2011.
2. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2011 përfshirë në totalin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të Kompanisë, bilanci i të arkëtueshmeve tregtare është 5,072,406 euro (31 Dhjetor 2010; 9,334,796 euro) neto nga provizionet për borxhe të këqija dhe të dyshimta në vlerë prej 33,738,211 euro. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë validitetin e këtij bilanci deri në datën e bilancit të gjendjes. Veç kësaj, dhe në lidhje me bilancin e provizionit të dëmit të të arkëtueshmeve, kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me saldon e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne prapë nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë më 31 Dhjetor 2011.
3. Ne nuk ishim prezent gjatë numerimit fizik të stokeve më 31 Dhjetor 2011 pasi që angazhimi i jone ishte pas kësaj date. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban organizata, ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të kënaqim vetveten në lidhje me vërtetësinë e këtij zëri dhe efektet e mundshme të tije në Pasqyrat Financiare.
4. Kompania nuk ka njohur ndonjë aset apo detyrim të tatimit të shtyrë dhe në të njëjtën kohë as shpenzim apo fitim të tatimit të shtyrë në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011 ashtu siç kërkohet me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit numer 12 “Tatimet në të Ardhura”. Ne mungese të procedurave alternative të auditimit ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nivelin e korrigjimeve, nëse do kishte pasur, të cilat do të kishin qenë të nevojshme me qëllim të regjistrimit të tatimeve në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit numer 12 “Tatimet në të Ardhura”.

*Mungesat ne shpalosje*

5. Pasqyrat financiare përcjellese nuk përmbajnë të gjitha shpalosjet që kërkohen me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) 7 – Shpalosjet e Instrumenteve Financiare dhe shpalosje tjera për humbje teknike.

***Mendimi***


Në mendimin tonë, përveç çështjeve të diskutuara në paragrafët më lart dhe efekteve të tyre në pasqyrat financiare, pasqyrat financiare të Kompanisë prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2011, si dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

**Çështjet e theksuara**

Duke mos e kualifikuar mendim tone, ne tërheqim vëmendjes si më poshtë:

Siç është shpalosur në Shënimin 13 të pasqyrave financiare përcjellese, librat dhe regjistrimet tatimore të Kompanisë nuk janë audituar nga Autoriteti tatimor për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011. Si rrjedhojë e kësaj, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen të finalizuara. Provizionet për taksat shtesë dhe gjokat, nëse ka ndonjë, nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.

Audit & Conto,

  
Ymer Shatri

24 Prill, 2012

NDERMARRJA SHËRBYESE  
**AUDIT & CONTO**  
sh.p.k.  
DDISUTINË

## Pasqyra e pozitës financiare

	Shënimi	2011	Me 31 Dhjetor 2010
<b>Pasuritë</b>			
<b>Pasuritë jo qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	54,545,625	57,393,895
		<b>54,545,625</b>	<b>57,393,895</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet, neto	4	1,698,003	1,672,264
Llogarite e arketueshme dhe kerkesat tjera, neto	5	5,072,406	9,334,796
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	6	1,614,348	1,251,254
		<b>8,384,758</b>	<b>12,258,314</b>
<b>Totali i pasurive</b>		<b>62,930,382</b>	<b>69,652,209</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali dhe rezervat	7	72,645,753	72,645,753
Fitimet (Humbjet) e Akumuluar	7	(11,641,647)	(8,434,555)
Fitimi (Humbja) e vitit		(324,143)	(1,939,934)
<b>Totali i ekuitetit</b>		<b>60,679,963</b>	<b>62,271,264</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet jo qarkulluese</b>			
Grantet e shtyra	8	1,336,531	1,243,175
		<b>1,336,531</b>	<b>1,243,175</b>
<b>Detyrimet qarkulluese</b>			
Llogarite e pagueshme dhe te tjera	9	759,170	1,440,384
Tatimi mbi vleren e shtuar	10	154,718	4,697,387
		<b>913,888</b>	<b>6,137,770</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>2,250,419</b>	<b>7,380,945</b>
<b>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</b>		<b>62,930,382</b>	<b>69,652,209</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 31 Mars 2011 dhe nënshkruar nga:

Z. Selatin Retkoceri  
Zyrtar i lartë financiar



Gjelosh Vataj  
Kryeshef Egzekutiv

## Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse

	Shenimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2011	2010
<b>Të hyrat operative</b>			
Te hyrat nga shitjet	11	11,692,861	10,857,097
Te hyrat nga grantet	8	482,188	88,343
Të hyrat tjera operative	12	752,338	653,398
		<b>12,927,387</b>	<b>11,598,838</b>
<b>(Shpenzimet) operative</b>			
Shpenzimet e pagave	13	(3,636,091)	(3,085,368)
Shpenzimet e zhvlersimit	3	(3,960,226)	(3,846,054)
Energjia Elektrike & Karburanti		(2,220,405)	(1,949,889)
Shpenzimet tjera operative	14	(1,804,396)	(1,380,018)
Lejimet për borxhet e keqija dhe të Dyshimta	5	(1,643,620)	(3,289,115)
		<b>(13,264,738)</b>	<b>(13,550,443)</b>
Te hyrat financiare		13,208	11,671
<b>Fitimi / (Humbja) para tatimit</b>			
		<b>(324,143)</b>	<b>(1,939,934)</b>
Tatimi në fitim	15		
<b>(Humbja)/Fitimi i vitit</b>		<b>(324,143)</b>	<b>(1,939,934)</b>

## Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Shenimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2011	2010
<b>Aktivitetet Operative</b>			
Fitimi (Humbja) para tatimit		(324,143)	(1,939,934)
<i>Përshtatur për:</i>			
Te hyrat nga grantet	8	(482,188)	(88,343)
Te hyrat nga provizionimi i stoqeve			
Zhvlerësimin	3	3,960,226	3,846,054
Te hyrat nga shlyerjet e borxheve të kqija		0	(489,711)
Korrigjimi i humbjeve të akumuluar	7	(1,267,158)	
Lejimet për borxhet e këqija	5	1,643,620	3,289,115
<b><i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapital punues</i></b>		<b>3,530,357</b>	<b>4,617,181</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
Stoqet	4	(25,739)	(271,100)
Të arkëtueshmet e tjera tregtare	5	2,618,769	(3,788,140)
Detyrimet e tjera dhe tregtare	9&10	(5,223,882)	460,363
		<b>(2,630,852)</b>	<b>(3,598,876)</b>
<b>Aktivitetet Investuese</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	3	(1,111,956)	(1,119,360)
		<b>(1,111,956)</b>	<b>(1,119,580)</b>
<b>Aktivitetet Financuese</b>			
Huat afatgjata			
Grantet e pranuar	8	575,544	457,411
		<b>575,544</b>	<b>457,411</b>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalentët e parasë</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	6	363,094	356,136
		1,251,254	895,118
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund</b>	<b>6</b>	<b>1,614,348</b>	<b>1,251,254</b>



## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

	Kapitali aksionar	Rezervat kapitale	Fitimet (Humbjet) e akumuluar	Totali
Me 01 Janar 2010	25,000	72,620,753	(8,434,555)	64,211,198
Fitimi /humbja e vitit			(1,939,934)	(1,939,934)
<b>Me 31 Dhjetor, 2010</b>	<b>25,000</b>	<b>72,620,753</b>	<b>(10,374,489)</b>	<b>62,271,264</b>
Fitimi /humbja e vitit			(324,143)	(324,143)
Korrigjimi i humbjeve të bartuara (shenimi 7)			(1,267,158)	(1,267,158)
<b>Me 31 Dhjetor, 2011</b>	<b>25,000</b>	<b>72,620,753</b>	<b>(11,965,790)</b>	<b>60,679,963</b>

## 1. Të Përgjithshme

Kompania Regjionale e Ujit "Prishtina" S.H.A, Prishtinë ("Kompania") është shoqëri aksionare e inkuorporuar me 29 Maj 2007 në Kosovë, pasues i Projektit i Korporatizimit të Sektorit Ujor në Kosovë. Kompania është totalisht pronë vartëse e Kompanisë Regjionale të Ujit "Prishtina" Holding S.H.A, dhe është pasardhëse legale e Kompanisë Publike "Ujësjetësi Regjional" – Prishtinë" Prishtinë. Adresa e Zyrës Qendrore është rruga Tahir Zajmi, Prishtinë, Kosovë.

Kapitali fillestar i kompanisë i regjistruar është në shumën 25 mijë Euro. Librat e kompanisë janë hapur me 1 Janar 2007 bazuar në Gjendjen e Bilancit fillestar, pastaj Raportin e studimit financiar si dhe rezultatet e periudhave të vlerësimit të performuara me 1 janar 2007 nga Konzorciumi Kurtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP USA New York dhe Grant Thornton Consulting DOO Maqedoni – Shkup ("Konzorciumi").

Kompania furnizon me ujë dhe ofron shërbime për ujera të zeza në komunat e Prishtinës, Fushe Kosove, Obiliq, Shtime, Lipjan dhe Podujevë. Mesatarja e punëtorëve të Kompanisë gjatë vitit 2011 është 536 persona.

## 2. Politikat e kontabilitetit

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

### 2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këtë shënim.

Këto pasqyra janë përgatitur nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e saj se paku në 12 muajt e ardhshëm.

Operacionet e Kompanisë janë të varura dhe të mbështetura nga grante me fonde të ndryshme. Menaxhmenti i konsideron të mjaftueshme fondet e jashtme që do të jenë të mundshme në të ardhmen të cilat do të mundësojnë Kompanisë pagesën e borxheve të tyre me kohë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të kërkon nga menaxhmenti të bëjë vlerësimet dhe parashikimet të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të asetëve dhe detyrimeve dhe shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrës financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së raportuar. Këto vlerësime janë bazuar në informatat e disponueshme në datën e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

## 2. Politikat e kontabilitetit (vazhdim)

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011. Të gjitha të dhënat janë të shfaqura në mijë euro (000 Euro) vetëm nëse nuk qëndron ndryshe. Me 01 Janar 2007 Kompania ka filluar me aktivitetet biznesore sipas statutit legal të ri – shoqëri aksionare.

### 2.2 Adoptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara

Gjate vitit 2007, Kompania ka adaptuar të gjitha Standardet e reja dhe të reviduara si dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe të Komitetit Interpretues Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (KINRF) të (BSNK) të cilat janë relevante në aktivitetet e saj dhe efektive për periudhat raportuese vjetore duke filluar prej 1 Janarit 2007. Adaptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara dhe Interpretimet nuk kanë rezultuar në ndryshimet e politikave të kontabilitetit të Kompanisë.

### 2.1 Monedhat e huaja

Transaksionet në monedha të huaja fillimisht regjistrohen në monedhën aktuale pastaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksioneve. Vlerat e Aseteve dhe detyrimeve në monedha të huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datat e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet e ndodhura nga shkëmbimet valutore paraqiten në pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve.

### 2.3 Prona, Impiantet dhe pajimet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve ekzistuese me 01 Janar 2007 janë bartur sipas rivlerësimit të bazuar në vlerësimin e bërë nga vlerësues të pavarur, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues. Efekti i rivlerësimit është vendosur në llogarinë e kapitalit. E gjithë prona, impiantet dhe pajisjet tjera janë paraqitur sipas koston zbritur për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimit të njësive (zërave).

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetëve apo janë njohur si asete të veçanta, siç ka qene me e përshtatshme, vetëm atëherë kur përfitime ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha kostot tjera për riparime dhe mirëmbajtje ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Toka nuk është e zhvlerësuar. Zhvlerësimi në pasuritë tjera është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar siç vijon:

Ndërtesat dhe rrjeti i ujesjellesit	5%
Pajisjet, Kompjuterët, Pajisjet e Zyrës,	20%

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.4 Dëmet e pasurive jo-financiare**

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe testohen çdo vit dëmet e tyre. Pasuritë të cilat janë subjekt zhvlerësimi rishikohen për dëmet kurdo që ka indikacione të cilat mund të tregojnë që vlera bartëse e tyre nuk mund të rikuperohet. Humbjet nga dëmet janë njohur në shumën për të cilën vlera bartëse e asetit e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlerë e rikuperimit merret me e larta e vlerës fer të shitjes së atij aseti minus kosto për shitjen apo vlera e kostos historike. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë janë të grupuara në nivelin më të ulët prej nga janë identifikuar ndaras rrjedhat e parasë (gjenerimi i njësisë të parasë). Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësinë e rikthimit të dëmeve në secilën datë raportimi.

### **2.5 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare të prezantuara në bilancin e gjendjes përfshijnë parane, ekuivalentet e parasë, llogarite e arkëtueshme dhe detyrimet. Kompania klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes relevante. Fitimet apo humbjet e interesit të ndërlidhura me instrumentet financiare të klasifikuara si asete, detyrime apo ekuitet janë të prezantuara si të hyra apo shpenzime, respektivisht.

Blerjet dhe shitjet e mjeteve financiare njihen në datën e tregtimit – data kur Kompania kryen blerjen apo shitjen.

### **2.6 Vlera fer e aseteve dhe detyrimeve kontigjente**

Vlera bartëse e reflektuar në bilancin përcjellës të parasë dhe ekuivalenteve të parasë, të të arkëtueshmeve dhe detyrimeve afatshkurtra përafron vlerën e tyre reale për shkak të maturimit relativisht të shkurtë të këtyre instrumenteve financiare..

### **2.7 Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera**

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe paraprakisht të matura me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëme. Provizionin për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arkëtueshmeve. Vështërsit e mëdha financiare të debitorit, me gjasë që debitori të bankrotoj apo të riorganizohet financiarisht, mospagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të aseteve dhe vlerës prezente të vlerësuar të rrjedhës së parasë së ardhshme, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurtër nuk janë zvogëluar. Vlera bartëse e aseteve zvogëlohet përmes përdorimit të një kontoje për lejim, dhe shumën e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në koston e 'shitjeve dhe të marketingut'. Kur një e

## **2. Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Kthimi i pastajshëm i shumave, më parë të shlyera kreditohen kundër 'shpenzimeve tjera operative' në pasqyrën e të ardhurave.

### **2.8 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në banka dhe në dorë. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përbëhet nga paraja dhe ekuivalentet e parasë të definuar si më lartë.

### **2.9 Stoqet**

Vlera e stoqeve paraqet me të ulëtën e kostos apo vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës në rrjedha të zakonshme të biznesit, zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kostoja parimisht është përcaktuar në baza të çmimit mesatar.

### **2.10 Kapitali Aksionar**

Kapitali aksionar është përcaktuar duke përdorur vlerën nominale të aksioneve që janë lëshuar.

#### **Rezervat**

Rezervat paraqesin ndryshimet ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të aseteve siç është përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e inkorporimit të Kompanisë.

### **2.11 Beneficionet e punëtorëve**

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror miratuara nga UNMIKU. Kontributet, bazuar në paga, bëhen tek , Trust i Kursimeve Pensionale Kosovës(TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

### **2.12 Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera**

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### **2.13 Tatimi në fitim rrjedhës dhe i shtyrë**

Tatimi në fitim rrjedhës kalkulohet në bazë të ligjit për tatime në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes.

## 2. Politikat e kontabilitetit (vazhdim)

Tatimi në fitim i shtyrë është parashikuar në tërësi, duke përdorur metodën e detyrimeve, në arritjen e diferencave të përkohshme në mes të bazës së taksave të pasurisë dhe detyrimeve dhe vlerën bartëse të tyre për qëllime të prezantimit në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur normën e tatimit që është në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes dhe pritet të aplikohet kur pasuria prej tatimit të shtyrë të realizohet apo detyrimi i tatimi të shtyrë është përcaktuar.

Kompania nuk ka njohur asnjë detyrim apo pasuri për tatim të shtyrë më 31 Dhjetor 2011.

### 2.14 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të ndërmarrjes dhe kur shumën e të hyrave mund të matet besueshëm. Te hyrat njihen sipas parimit aktual, në momentin e fitimit.

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kryerjen e shërbimit ose në datën e origjinës. Shpenzimet njihen sipas parimit aktual, në momentin e ndodhjes.

### 2.15 Grantet Qeveritare

Grantet nga qeveria njihen në vlerën reale kur ka një siguri të arsyeshme që grantet do të mirren dhe Kompania do të përbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare në lidhje me shpenzime janë të shtyera dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur shpenzimet për të cilat ka qene i dedikuar granti.

Grantet qeveritare në lidhje me blerjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyre dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në baza drejt-vizore sipër jetës së pritur për pasuritë e lidhura.

### 2.16 Provizionet

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhje e burimeve të mishëroj beneficionet ekonomike që do të jenë të kërkuara që të shlyhet obligimi dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në shumën e obligimit.

### 2.17 Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç në rastet kur ekziston mundësia që kompania në një të ardhme të ketë dalje të asetëve si pasojë e përbushjes së detyrimeve. Shumën e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, detyrimi ka ndodhur në datën e bilancit të gjendjes dhe mund të behet parashikim i arsyeshëm humbjeve.

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.18 Ngjarjet Pasuese**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë ngjarje që rregullojnë zërat e bilancit të gjendjes për atë datë janë shpalosur në shënime në rastet kur këto shuma janë materiale.

### 3. Prona, impiantet dhe pajisjet

Kosto	Toka	Ndertesat	Rrjetat e ujësjetës	Pajisjet dhe makinerite	Automjetet	Investimet ne vijim	Totali
Me 1 Janar 2011	18,412,200	12,262,127	32,547,573	6,921,725	689,527	484,900	71,318,052
Blerjet gjate vitit		12,423		313,295	63,851	722,387	1,111,956
T transferimet gjate vitit		479,001	159,862	-	-	(638,863)	-
Shitjet / Huhjet gjate vitit							
<b>Me 31 Dhjetor 2011</b>	<b>18,412,200</b>	<b>12,753,551</b>	<b>32,707,435</b>	<b>7,235,020</b>	<b>753,378</b>	<b>568,424</b>	<b>72,430,007</b>
<b>Zhvleresimi i Akumuluar</b>							
Me 1 Janar 2011	-	(2,374,927)	(6,837,921)	(4,281,768)	(429,541)	-	(13,924,156)
Zhvleresimi i vitit	-	(619,977)	(1,780,694)	(1,412,076)	(147,478)	-	(3,960,227)
Rregullimet e lidhura me shitje/ huhje							
<b>Me 31 Dhjetor 2011</b>	<b>-</b>	<b>(2,994,904)</b>	<b>(8,618,615)</b>	<b>(5,693,844)</b>	<b>(577,019)</b>	<b>-</b>	<b>(17,884,383)</b>
Vlera neto ne libra							
Me 1 Janar 2011	18,412,200	9,887,200	25,709,653	2,639,957	259,986	484,900	57,393,895
Me 31 Dhjetor 2011	18,412,200	9,758,647	24,088,820	1,541,175	176,359	568,424	54,545,625



#### 4. Stoqet

	2011	Me 31 Dhjetor 2010
Materialet dhe Furnizimet	1,797,809	1,812,346
Minus: (provizionit) për lëvizjet e ngadalshme dhe stoqet e vjetruara	(99,806)	(140,082)
	<b>1,698,003</b>	<b>1,672,264</b>

#### 5. Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

	2011	Me 31 Dhjetor 2010
<u>Të arkëtueshmet tregtare</u>		
Konsumatorët vendore	38,657,682	41,048,072
Minus: (provizionit) për borxhe të këqija dhe të dyshimta	(33,738,211)	(32,094,591)
	<b>4,919,471</b>	<b>8,953,481</b>
<u>Të arkëtueshmet e tjera rrjedhëse</u>		
Kërkesat nga punetoret	117,873	144,862
Të arkëtueshmet e tjera	35,063	236,453
	<b>152,935</b>	<b>381,315</b>
<b>Total llogarite e arkëtueshme tregtare dhe të tjera</b>	<b>5,072,406</b>	<b>9,334,796</b>

Tabela e mëposhtme përmbledh lëvizjet në llogarinë e provizionit të borxheve të këqija:

	2011	2010
Me 01 Janar	32,094,591	28,805,477
Lejimet për borxhe të këqija dhe të dyshimtate njohura gjatë vitit	1,643,620	3,289,115
Shlyerjet e borxheve të këqija		
<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>33,738,211</b>	<b>32,094,591</b>

Gjatë vitit 2011 Kompania ka korigjuar llogarite e arkëtueshme të viteve të mëhershme për të reflektuar zvogëlimin e faturimeve të viteve paraprake në të cilat ishin përfshirë faturimet e bëra në emër të humbjeve të ujit në ujësjellës.

## 6. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	2011	Me 31 Dhjetor 2010
Llogaritë rrjedhëse me bankat vendore	1,609,556	1,250,135
Paraja në dorë	4,792	1,119
	<b>1,614,348</b>	<b>1,251,254</b>

## 7. Ekuiteti

### Kapitali aksionar

Kompania është e regjistruar në Agjensionin Kosovor për Regjistrimin e Bizneseve më 31 Maj 2007. Sipas të dhënave nga dosja e Regjistrimit, kapitali aksionar i Kompanisë ka shumën 25,000 Euro.

### Rezervat

Rezervat të cilat më 01 Janar 2010 janë në shumën 72,620,753 mije euro, fillimisht njihen në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes si diferenca në mes vlerës neto të Kompanisë dhe vlerës së kapitalit aksionar fillestar kontribuar nga aksionarët e Kompanisë. Rezervat zvogëlohen çdo vit për pjesën e zhvlerësimit të aseteve të rivlerësuara.

Gjate vitit 2011 Kompania ka rritur humbjet e akumuluar në vlerë 1,267,158 për të reflektuar zvogëlimin e të hyrave të viteve paraprake në të cilat ishin përfshirë faturimet e bëra në emër të humbjeve të ujit në ujësjellës.

## 8. Grantet

	2011	2010
Me 01 Janar	1,243,175	873,617
Shtesat gjate vitit	575,544	457,411
Shtesat – materialet		
Te hyrat e njohura gjate vitit	(482,188)	(87,853)
<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>1,336,531</b>	<b>1,243,175</b>

## 9. Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera

	Me 31 Dhjetor	
	2011	2010
<u>Kreditorët Tregtar</u>		
Furnizuesit Vendorë	682,324	1,182,157
	<b>682,324</b>	<b>1,182,157</b>
<u>Detyrimet e tjera kurente</u>		
Tatime dhe kontribute	56,624	234,648
Tjera	20,222	23,579
	<b>76,846</b>	<b>258,227</b>
	<b>759,170</b>	<b>1,440,384</b>

## 10. Detyrimi i TVSH-se

Kompania ne vitin 2011 ka prezentuar detyrimin ndaj TVSH-se bazuar ne Inkasim ne vlere 154,718 EURO , ashtu siq eshte e rregulluar me Memorandumin per pagesen e TVSH-se nga kompanite publike.

## 11. Shitjet

	Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor	
	2011	2010
Uji	9,088,550	8,703,673
Kanalizimi	864,957	826,675
Tarifa fikse	1,244,191	1,153,426
Sherbimet	335,227	48,753
Kyqjet	159,936	124,570
<b>Total shitjet</b>	<b>11,692,861</b>	<b>10,857,097</b>

## 12. Te hyrat tjera

	Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor	
	2011	2010
Shlyerja e detyrimeve	719,197	
Kthimi i provizioneve te borxheve te kqija		489,712
Tjera	33,141	163,686
<b>Total shitjet</b>	<b>752,338</b>	<b>653,398</b>

### 13. Kostoja e stafit

	Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor	
	2011	2010
Pagat e punëtoreve	2,389,319	2,085,812
Shpenzimet e ushqimit per punëtor	297,756	286,624
Stimulimet per pune	542,604	398,129
Kontribute pensionale	172,929	145,187
Shpenzimet tjera te stafit	233,484	169,616
	<b>3,636,091</b>	<b>3,085,368</b>

### 14. Shpenzimet tjera operative

	Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor	
	2011	2010
Mirëmbajtja dhe riparimet	106,588	113,351
Shpenzime tjera administrative		
Sherbimet e jashtme kontraktuese	461,612	453,691
Shpenzimet materiale	665,339	664,917
Uji i blere me shumice	88,957	75,030
Studimi i fizibilitetit	385,000	
Shpenzimet e tjera	96,899	73,029
<b>Total shpenzimet tjera operative</b>	<b>1,804,396</b>	<b>1,380,018</b>

### 15. Shpenzimet e tatimit në fitim

Bazuar në Ligjin mbi Tatimin ne Fitim te Korporatave 03-L-162 në fuqi 01 Janar 2010, nga Kompania kërkohet të paguajë normë të taksës nga 10% të fitimit të tatueshëm për vitin 2011 (vitin 2010; 10%), që kullohet në pasqyrën vjetore kthyesë të tatimit në fitim.

Kompania ka pasur humbje nga operacionet e saj për 2011 dhe nuk ka detyrim tatimit në fitim për periudhën referuese.

## 16. Kontingjentet dhe detyrimet

Detyrimet tatimore

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2011 dhe 2010 nuk janë audituar nga autoriteti i tatimor vendor. Detyrimet e tatimeve të kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara. Taksa shtesë që mund të dalin gjatë inspektimit nuk mund të vlerësohen me saktësi.

## 17. Risku i menaxhimit financiar

Menaxhmi i riskut i Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorëve. Menaxhmi i riskut është i fokusuar në pa parashikushmerin e tregjeve dhe mundohet të minimizoj efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Kompanisë.

### 17.1 Risku kreditor

Kompania nuk ka koncentrim domethënës të riskut kreditor. Maksimumi i ekspozimit të Kompanisë ndaj riskut kreditor prezantohet nga shuma bartëse e secilit mjet financiar në bilancin e gjendjes.

### 17.2 Menaxhimi i riskut kapital

Objektivat e Kompanisë, kur menaxhojn me kapital, janë të ruajnë mundësin që Kompania të vazhdoj vijueshmërinë në mënyrë që të siguroj kthime për aksionaret dhe përfitime për palët tjera të përfshira dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit që të ulë koston e kapitalit.

Në mënyrë që të mirëmbaj apo rregulloj strukturën e kapitalit, Kompania mund ta rrisë apo kthej kapitalin të aksionaret apo shes pasurit që të ulë detyrimet.

### 17.3 Vlerësimi i vlerës reale

Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera të kompanisë, mjetet likuide si dhe detyrimet kanë afat maturimi të shkurtër. Si rrjedhojë e kësaj vlere bartëse korrespondon me vlerën reale të tyre.